

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N.T.SH “[V... ]”, me seli në Prishtinë të cilën e përfaqëson sipas autorizimit “[A.I]“ avokat nga Prishtina, kundër të paditurit “[P... ]”, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqeson sipas autorizimit “[I.O]“ avokate nga Prishtina për shkak të anulimit të pjesëshem të kontratës duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtine –Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.435/2014, të datës 10.03.2017, seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 06.11.2019, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit N.T.SH “[V... ]”, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.435/2014, të datës 10.03.2017, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kerkesëpadinë e paditësit N.T.SH “[V... ]”, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurit “[P... ]”, me seli në Prishtinë, me të cilën ka kerkuar : Të anulohet kontrata përfurnizim KSV/014.12 051, e lidhur ne mes të paditësit dhe të paditurit me Ministrinë e Shendetësisë së Republikës së Kosovës, projekt i Qeverisë së Holandës dhe Luksemburgut, në pjesën që i referohet të paditurit “[P... ]”, me seli në Prishtinë. Për paditësin N.T.SH “[V... ]”, me seli në Prishtinë, kontrata e lartcekur të ngelë në fuqi. Të detyrohet i padituri “[P... ]”, me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material paditësit t’ia paguaj shumën prej 30,000.00€, ndërsa në emër të fitimit të munguar t’ia paguaj shumën prej 830,000.00€. Ndërsa në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar paditësi, që të paditurit t’ia paguaj shumën prej 2,215.20€, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afat prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë e paditësi, N.T.SH “[V... ]”, me seli në Prishtinë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ta aprovoj ankesën e paditësit si të bazuar, ta prishë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.435/2014, të datës 10.03.2017, ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe lendën ta kthej në rishqyrtim dhe rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar pala e paditur duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ta refuzoj ankesën e palës paditëse si të pabazuar dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.435/2014, të datës 10.03.2017, ta vertëtojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti

#### Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi N.T.SH “[V... ]”, me datë 11.08.2014, ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurit, “[P... ]”, me seli në Prishtinë, për anulim të pjesëshem të kontratës duke kerkuar nga gjykata që ta miratojë kerkesëpadinë si të bazuar dhe të obligohet i padituri që në emër të dëmit material paditësit t ia paguaj shumën prej 30,000.00€, ndërsa në emër të fitimit të munguar t ia paguaj shumën prej 830,000.00€.

Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara ka konstatuar së paditësi dhe i padituri me datën 18.04.2012, kanë nënshkruar marrëveshje të përbashkët të ndërmarrjes me çrast të dyja palët kanë kemyer informata për bizneset e tyre. Sipërmarrja e përbashkët është emëruar si “[P...], [V... ]”. Qellimi themelor i bashkëpunimit ka qënë përgatitja e ofertës dhe pjesëmarrja në tender të shpallur nga Lux Development, në emër të Ministrisë Shendetësisë së Republikës së Kosovës. Palët janë dakorduar që lider i sipërmarrësisë është [P...], ndërsa anëtarë është [V...]. Kontratën e ka nënshkruar [Y.SH], në emër të [P... ] dhe [G.H], në emër të [V... ]. Kjo dëshmohet nga provat – marrëveshje e përbashkët e ndërmarrjes e lidhur me datë 18.04.2012. me datën 18.04.2012 dhe me dt.20.11.2012, [P... ], dhe [V... ] e kanë autorizuar me shkrim z. [Y.SH] që të ndërmarrë gjitha aktivitetet në emër të sipërmarrës duke përfshirë përgatitjen e dokumenteve, dorëzimin e ofertës dhe ekzekutimin e kontratës. I autorizuari z. [Y.SH], ka përgatitur dokumentacionin dhe ka paraqitur ofertën në emër të sipërmarrës “[P... ] & [V... ]” e cila pastaj është shpallur fituese e tenderit.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur së me datën 10.03.2014 është lidhur kontrata e furnizimit “[...]” në mes të Ministrisë Shendetësisë, si autoritet kontraktues dhe Grupimit “[P... ] [V... ]” si operator ekonomik. Në emër të sipërmarrjes apo grupimit siç është quajtur në tender, kontratën e ka nënshkruar z. “[Y.SH]”. Të dy palët e kanë pranuar përfaqesimin si të rregullt dhe kanë filluar me përbushjën e zotimeve të marra me kontratë. Po ashtu gjykata ka konstatuar faktin së në kohën e lidhjes së kontratës z. “[Y.SH]” ka qenë Menaxher i Përgjithshem i të paditurit, ndërsa me datën 18.07.2014 në mbledhjen e aksionarëve të palës së paditur është emëruar drejtor i dytë menaxhues. Në të njëjtën datë, aksionarët e palës së paditur në menyrë unanime dhe të pakushtëzuar i kanë konfirmuar dhe pranuar të gjitha transaksionet e kryera nga z. Ymer Shahini, në emër të palës së paditur duke përfshirë edhe kontratën me Ministrinë. Po ashtu nga procesverbal i mbledhjes së aksionarëve të “[P... ]”, datë 18.07.2014 është konstatuar se aksionarët e kësaj shoqerie tregtare kanë konfirmuar së z.

"[Y.SI]" ka vepruar si person i autorizuar. Nga faktet e vërtetuara gjykata e shkallës së parë, ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar duke u bazuar në dispozitat e nenit 72 parografi 1 të LMD-së, dhe në dispoziten e nenit 452. Par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsy se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b ), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkalles së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht dispozitën e nenit 72 parografi 1 të LMD-së, i cili parashev se: "*Lidhja e kontratës dhe punët e tjera juridike mund të kryhen edhe me përfaqësues*". Në rastin konkret personi i cili e ka nënshkruar kontratën ka qenë i autorizuar ta nënshkruaj kontratën, dhe kjo vëretohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës respektivisht nga autorizimet e datës 18.04.2012 dhe 20.11.2012 si dhe nga procesverbalë i datës 18 korrik 2014, nga i cili konfirmohen veprimet e z. "[Y.SI]", si person ka qenë i autorizuar për të ndermarrë veprimet lidhur me kontratën kontestuese. Prandaj pretendimi i paditësit për anulimin e kontratës vetëm për të paditurin për shkak të mungesës së autorizimit për z." [Y.SI]", për lidhjen e kontratës, është i pa bazuar. Gjykata e Apelit ka vlersuar edhe pretendimet e palës paditëse lidhur me mos marrjen e provave me degjimin e dëshmitarëve, si dhe nxjerrjen e ekspertizës në lemin e IT-së, mirëpo kjo gjykatë vleron së gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar këto pretendime të palës paditesë, për arsy së veprimet e z. Ymer Shahini kanë qenë të autorizuara.

Poashtu janë ta pabazuara pretendimet ankimore lidhur me refuzimin e ndyshimit të padisë sepse nga parashresa e paditësit, e datës 21.09.2016, rezulton se pavarësisht zvogëlimit të shumës së kërkuar paditësi e ka ndryshuar padinë dhe ka parashtruar kërkesa të reja. Më padinë fillestare ka kërkuar kompensimin e dëmit ndërsa me parashtresën e datës 21.09.2016 ka kërkuar pagesën e borxhit andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka konstatuar se kemi ndryshim të padisë sepse bazuar në dispozitën e Nenit 257.1 të LPK-së, *ndryshim të padisë përbërëndë ndryshimi i njëjtësisë së kërkësëpadisë, zmadhimi i kërkësëpadisë apo parashtrimi edhe i një kërkese tjetër krahas asaj ekzistuese*. Në rastin konkret kemi ndryshimin e njëjtësisë së kërkësëpadisë dhe parashtrimin e kërkësës tjetër nga ajo e parashtruar më padi, e për të cilat kërkohet administrim i provave tjera dhe vërtetim i gjendjes faktike lidhur me kërkësen e re.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të së paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsyet e mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitivinë bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,  
Ae.nr. 103/2017, dt. 06.11.2019**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**

Mahir Tutuli, d.v.

